

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më ____ /08 /2026

PROCES VERBAL – Tipi i kontratës – e hapur Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është pjesë e pandarë e publikimit bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti : Rikualifikim i bllokut të banimit në lagjen "Isa Boletini për vitin 2026

Fondi Limit: 358,666,664 (treqind e pesëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) Leke pa TVSH .

REF-96851-08-20-2026

E hapur pune

Kodi CPV: 45000000-7 - Punë ndërtimi,

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: "Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik": citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-së).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h', 'i', 'j' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të certifikuar nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1

a. Punë të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudit;
- Çertifikaten e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Leje ndërtimi;

- Formular/Vërtetim-Vlerësimi nga Investitori.
- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë së bashku me ndarjen e punimeve mes operatorëve.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve".

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

Për punimet në ndërtim:

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P-3 D Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- NP-4 C Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro etj;
- N.P-7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje;
- NP-11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit;

Për punimet speciale të ndërtimit :

- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- N.S.-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- N.S-6-A Sinjalistika rrugore jo drriqese;
- N.S-18-A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ku neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane". Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko-profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria	Përshkrimi i kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Referuar kapitullit të gërmimeve sipas parashikimit të projekt preventivit prishje/gërmime/transport/mbushje (punime për prita, gërmime shkarkimi, mbushje, transport mbeturinash). Për këtë arsye kërkohet licenca NP-1A për të garantuar që operatori ka kapacitetin teknik dhe përvojën për punime të tokës.	A	0-20 milion
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finiturat e llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Referuar projektit dhe specifikimeve teknike.	D	101 – 200 milion
NP-4	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro etj.	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet e në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën niparavele dhe në lartësi, parkimet, punimet e mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudha me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet e realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtimet, mirëmbajtjet ose rikonstruksion i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor te nevojshëm për të ndërjër paqëndrueshmërinë mbi goma, hekur, zona, kushdo që të jete shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose paisje edhe e tipit të veçantë, të linjes hekurudhore. Për këtë arsye kërkohet licenca NP-4C për të garantuar që operatori ka kapacitetin teknik dhe përvojën për punime të tokës.	C	50-100 milion
NP-7	Ujësjetes, gazsjelles, vajsjetes, vepra kullimi e vaditje.	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vleres se punimeve te preventivit te punimeve KUB, kullimi etj.).	A	0-20 milion
NP-11	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike, punimeve te çmontim linja elektrike, spostim shtylla, F.V. linja te reja, shtylla ndricimi etj.	A	0-20 milion
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Referuar punimeve te inxhinierisë së mjedisit, Punime sistemimi te jashtme, rehabilitim mjedisor.	A	0-20 milion
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve.	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike. Referuar preventivit mbi Punimet per prishjen e ndertimeve ekzistuese rrugore, kanalizime, mure, etj.	A	0-20 milion
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës te çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime te ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, te dyerve dhe dritareve te brendshme dhe te jashtme, te veshjeve te brendshme dhe te jashtme te dyshemeve te tipeve te ndryshme dhe me materiale te ndryshme dhe te punimeve te realizuara me dore, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose te ngjashem. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave te ndryshme dhe me materiale te ndryshme. Referuar projektit dhe specifikimeve teknike.	A	0-20 milion

Kategoria	Përshkrimi i kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NS-6	Sinjalistika rrugore jondricuese.	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike. Referuar preventivit mbi Sinjalistika rrugore jondricuese.	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	Konsiderohet zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.	A	0-20 milion

Kategoritë e mësipërme janë kërkuar referuar zërave të preventivit dhe vlerës përkatëse të cilat i përgjigjen klasifikimit të mësipërm.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisit
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Ing. Elektrik
- 1 (një) Arkitekt/urbanist

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h', 'i', 'j' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinier Ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licensën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licensën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidroteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licensën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Mjedisit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licensën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike te objektit që prokurohet për secilin nga zerat e punimeve të instalimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zerat e punimeve Elektrik, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

Arkitekt është përgjegjës për interpretimin e saktë të projektit që prokurohet. Projekti objekt kontrate dikton praninë gjatë zbatimit të punimeve dhe kërkon ekspertizë profesionale të një arkitekti, kjo për faktin se në projekt ka kompleksitet punimesh dhe zërash, si dhe punime të rifiniturës, elementesh dhe forma të ndryshme, ngjyrash që do aplikohen, sistemimi i sipërfaqeve të gjelbëra, ndërthurja e tyre, me stolat, pemet dekorative, bordurat etj. Për realizimin e të cilave duhet prania ekspertiza e arkitektit, sipas rekomandimit të supervisorit, Investitorit.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e këtyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar parashikohet se: "Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë."

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka përzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve duke u bazuar në natyrën e kësaj pune.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Kontratë pune e vlefshme;

b) Diplomë.

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c". Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë që ka të bëjë me Furnizim Vendorsje sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", konkretisht pika 1.2 ku citohet se: "drejtuesit ligjorë dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi" si dhe pikës 2.1 ku citohet se "drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit".

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2 ku përcaktohet se: "Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit" dhe pika 2: "elementët e licencës" gërma "c" ku citohet se: "Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë".

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga rëndësia e objektit të kontratës, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë pune te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Profesioni/Kualifikimi	Numri i te punësuarve
Teknik të mesëm ndërtimi	1
Teknik te mesëm Topograf	1
Elektriciist	2
Hidraulik	2
Betonues	2
Karpentier	2
Hekurkthyes	2
Bojaxhi	2
Hidroizolues	2
Murator/Suvatues	4
Mekanik	2
Saldator	1
Punonjes Asfalti	4
Manovrator (eskavatoriste, buldozeriste, automakiniste) pajisur me Dëshmi Aftësie Profesionale	8
Shofer pajisur me Çertifikate Aftësie Profesionale	10
Punëtor të thjeshtë ,pllakastues,specialist kapote	73

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", te rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Për punonjësit eskavatorist/ manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

a) kontratë individuale të punës;

leje drejtimi, certifikate e aftësitë profesionale (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftësimi profesional (DAP) për manovratorët/automakinistët, që të vërtetojnë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre", miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h', 'i', 'j' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores 'Për sigurinë në kantier'".
- 1 (një) punonjës "Ekspert i pajisur me certifikatë për vlerësimet e ndikimit në mjedis" për zberthimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- 1 (një) punonjës "Ekspert zjarrfikës MNZSH" për vlerësimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në raste emergjencash.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- *Kontrate pune noteriale, Diplomë/certifikatë/Dëshmi kualifikimi, si dhe të jenë në listepagesa për periudhën 3 (tre) muji i fundit.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores 'Për sigurinë në kantier'" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatorët ekonomikë, gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të kenë kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe i papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....".

Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas certifikimit përkatës shmanget dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funkcioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave

parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", ku citohet se: "Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për persona fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit".

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: Punime në ndërtesa, mes banoreve dhe fëmijëve, shtrirja në territor të banuar, përdorimi i mjeteve paisjeve elektrike për prerje, ngjitje të tubacioneve etj, përdorimi i lëndëve të rrezikshme si, ato të hidroizolimeve, bojrave, bitume dhe hedhja e asfaltit me temperaturë të lartë, etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkojnë një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në rast aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

2.3.7 Një punësim jo me pak se 130 (njëqind e tridhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkojnë nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlogaritjen e numrit të punonjësve, njësi e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-se dhe legjislacionin tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhen të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krah, drejtuesit e mjeteve të thjeshta dhe të rënda, punonjës, siguri, roje, etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve dhe shtrirjen në bllok banimi.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtorë si dhe stabilitetin e saj është duke kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe në listëpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe sipas të ciles: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve klasifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Statusi/Pronësia
1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 2 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Kamionçina me kapacitet mbajtës 2 deri 4 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Kamion pajisur me vinç kapacitet ngritës mbi 4 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Vinç Kollon Lartesi minimumi 50 ml, kapaciteti minimal 2 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Fadrome/Skrep Kovë përpara dhe mbrapa	1 copë	Në pronësi ose me qera
10	Minieskavatore	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Eskavator pajisur me çekiç dhe pincë	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Rul Gome Cilinder mbi 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Rul Gome Cilinder 2-6 ton asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Rrul cilinder-cilinder 6-8 ton asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
20	Autobetoniere ATV	2 cope	Në pronësi ose me qera
21	Autopompe betoni APV	1 copë	Në pronësi ose me qera
22	Sharre/prerese asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera
23	Skeleri minimumi 4800 m2	1 copë	Në pronësi ose me qera
24	Makineri/Fshese Asfalti	1 cope	Në pronësi ose me qera
25	Makineri frezimi traseje Rruge	1 copë	Në pronësi ose me qera
27	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
28	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera
29	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
30	Pompa uji	3 copë	Në pronësi ose me qera
31	Autovinç me kapacitet ngritës te paktën 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
32	Kamion pajisur me kosh për punime ne lartesi	1 copë	Në pronësi ose me qera
33	Bob Cat ose ekuivalent	2 copë	Në pronësi ose me qera
34	Pirun ngritës	1 copë	Në pronësi ose me qera
35	Betoniere kantieri 500 litra	2 copë	Në pronësi ose me qera
36	Depozita Uji 1000 litra	4 copë	Në pronësi ose me qera
37	Armature dërrase	100 m2	Në pronësi ose me qera
38	Paisje topografike/topogjeodezike GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera
39	Semafore sinjalistike per punime rrugore	2 copë	Në pronësi ose me qera
40	Matrapik	1 copë	Në pronësi ose me qera
41	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	40 copë	Në pronësi ose me qera
42	Fikse zjarri	20 copë	Në pronësi ose me qera
43	Jeleke Pune	130 copë	Në pronësi ose me qera
44	Prozhektore ndricimi	10 copë	Në pronësi ose me qera
46	Makineri Vijeziimi rrugor boje bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qera
47	Kompresor	2 copë	Në pronësi ose me qera

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Statusi/Pronësia
48	Gjenerator minimumi 50KVA	2 copë	Në pronësi ose me qera
49	Zyre mobile (e levizeshme) kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
50	Rimorkiator - Tërheqës	1 cope	Në pronësi ose me qera
51	Rimorkio kapacitet mbajtes mbi 30 ton për transportin e makinerive te rënda për në kantier (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)	1 cope	Në pronësi ose me qera
52	Impiant/Fabrikë Asfalti pajisur me leje mjedisore kodë III.1.B si dhe ISO 9001:2015, me kapacitet te paktën 100 ton/orë, me distance jo me te madhe se 50 km nga objekti i kontrates.	1 copë	Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi
53	Fabrikë Betoni pajisur me leje mjedisi kodë III.1.B.	1 copë	Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi
54	Impiant/Nyje Inerte pajisur me leje mjedisi kodë III.1.B.	1 copë	Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
- Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
- Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- Kontrata e qerasë
- Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
- Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
- Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira).

- Për mjetet e transportit për mallrat e klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash te rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

- Operatori ekonomik duhet te deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës se makinerive.

a. Për fabrikën/impianin e asfaltit duhet të paraqiten Leje mjedisi tipi B, kodë III.1.B, dokumentat e pronësisë ose kontrata e qerasë (nëse është marrë me qera duhet kontratë qeraje noteriale) ose kontratë furnizimi noteriale, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi, si dhe ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së materialit nga prodhuesi. Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet ne temperaturën 155 °C deri në 170 °C, Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 50 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit jo më pak se 140 °C, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe V.K.M. Nr. 628, datë 15.07.2015.

Në rast se ofertuesi disponon kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartepërmendur shoqëruar me kontraten noteriale te furnizimit (e vlefshme përgjatë gjithë afatit te kesaj kontrate), si dhe shoqëruar me deklaratën e garancisë së prodhuesit ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara

sipas preventivit dhe afati i furnizimit. Kërkesa e mësipërme për disponimin, në format e pronësise, qirase, apo dhe marrëveshjes së furnizimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës në kohë dhe në kushtet e volumeve të mëdha të materialeve asfalte të krijohet besueshmeria që ofertuesi është në gjendje dhe gëzon garancinë e furnizimit të këtyre materialeve si në sasi, në cilësi, dhe në kohën e parashikuar në grafikun e punimeve të miratuar.

b. Për fabrikën e betonit duhet të paraqiten Leje mjedisi tipi B, dokumentat e pronësise ose kontrata e qerasë (nëse është marrë me qera duhet kontratë noteriale) ose kontratë furnizimi noteriale e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të objektit të këtij prokurimi, si dhe ISO 9001:2015, mbi certifikimin e cilësisë së materialit nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi disponon kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartëpërmendur shoqëruar me kontratën noteriale të furnizimit (e vlefshme përgjate gjithë afatit të kësaj kontrate), si dhe shoqëruar me deklaratën e garancisë së prodhuesit ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara sipas preventivit dhe afati i furnizimit. Kërkesa e mësipërme për disponimin, në format e pronësise, qirase, apo dhe marrëveshjes së furnizimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës në kohë dhe në kushtet e volumeve të mëdha të materialeve përkatëse të krijohet besueshmeria që ofertuesi është në gjendje dhe gëzon garancinë e furnizimit të këtyre materialeve si në sasi, në cilësi, dhe në kohën e parashikuar në grafikun e punimeve të miratuar.

c. Për fabrikën/nyjen e inerteve duhet të paraqiten Leje mjedisi tipi B, dokumentat e pronësise ose kontrata e qerasë (nëse është marrë me qera duhet paraqitur kontratë noteriale qeraje) ose kontratë noteriale furnizimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, si dhe ISO 9001:2015, mbi certifikimin e cilësisë së materialit nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi disponon kontratë furnizimi noteriale, duhet të paraqitet dokumentacioni i lartëpërmendur shoqëruar me kontratën noteriale të furnizimit (e vlefshme përgjate gjithë afatit të kësaj kontrate), si dhe shoqëruar me deklaratën e garancisë së prodhuesit ku të jetë i përshkruar emërtimi i objektit që prokurohet, sasitë e kërkuara dhe afati i furnizimit. Kërkesa e mësipërme për disponimin, në format e pronësise, qirase, apo dhe marrëveshjes së furnizimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës në kohë dhe në kushtet e volumeve të mëdha të materialeve (inerte cakull, stabilizant, rrëzë, granile etj) të krijohet besueshmeria që ofertuesi është në gjendje dhe gëzon garancinë e furnizimit të këtyre materialeve si në sasi, në cilësi, dhe në kohën e parashikuar në grafikun e punimeve të miratuar.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shprehës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h', 'i', 'j' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standarteve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetet e tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Argumentimi
1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	3 copë	Për realizimin e transportit të asfaltit në kantier në kuadër të realizimit të zerave: "Shtresë binderi me granit gur kave, 6cm, me makineri" dhe "Shtresë asfaltbetoni me granit gur kave, 4cm, me makineri". Këto zëra punimesh përfshijnë transportin në kantier, shtrimin dhe ngjeshjen e duhur të asfaltbetonit të ngrohtë në shtresën e përcaktuar në Projekt. Sipas Preventivit janë parashikuar rreth 16 mijë m ² , ku duhet të paktën 3 kamiona 30 ton që të operojnë në forme stafete, për të patur një realizim korrekt dhe në kohën e duhur të shtresave pa vonesa dhe ruajtjen e temperaturës së masës së asfaltbetonit i cili mbas shkarkimit nga përzieresi duhet të jetë në kufijtë 140 deri 160°C.
1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	1 copë	Për realizimin e zerit: Transport materiale ndërtimi, dhe me auto deri 10.0km.
2	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	1 copë	Për zerat mbushje me cakull, shtrese stabilizanti, shtrese cakulli, mbushje etj.
3	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	2 copë	Kamionçinat për aftësi të tyre të operimit, janë të nevojshme për transportimin e mjeteve të punës, të sigurimit teknik, materialeve relativisht të lehta, etj.
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 2 ton	2 copë	Kamionçinat për aftësi të tyre të operimit, janë të nevojshme për transportimin e tabelave, elementeve metalik, kapakeve të pushtave, etj.
5	Kamionçina me kapacitet mbajtës 2 deri 4 ton	2 copë	Kamion pajisur me vinç të nevojshëm për transport dhe vendosje në objekt të elementeve, tuba, ngarkime apo shkarkime të materialeve hekur, cemento, etj.
6	Kamion pajisur me vinç kapacitet ngritës mbi 4 ton	1 copë	Për punimet e taracave cativë, ngritjen e elementeve të ndërtimit, etj.
7	Vinç Kollon Lartesi minimumi 50 ml, kapaciteti minimal 2 ton	1 copë	Për realizimin e Germim dhe me ekskavator goma 0.25 m ³ .
8	Eskavator me goma	1 copë	Për realizimin e zerave mbushje me gur kave, kasoneta, gropa pushtash, themele mure betoni, etj.
9	Fadrome/Skrep Kovë përpara dhe mbrapa	1 copë	Për realizimin e mbushjeve dhe mbulimit të kanaleve të tombinove.
10	Minieskavatore	1 copë	Germim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir i nevojshëm për material shkëmbor në zbatimin e mureve të betonit, skarpave etj.
11	Eskavator pajisur me çekiç dhe pincë	1 copë	Për ngjeshjen e trasës së kasonetes së rrugëve.
13	Rul Gome Cilinder mbi 10 ton	1 copë	Për realizimin e zerit "Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20cm".
14	Rul Gome Cilinder 2-6 ton asfalti	1 copë	Për realizimin e ngjeshjes Shtresë asfaltbetoni me granit gur kave, 4cm, me makineri rreth 16 mijë m ² , ku duhet të realizohen të paktën 8 kalime mbi sipërfaqen e shtruar.
15	Rrul cilindër-cilindër 6-8 ton asfalti	1 copë	Për realizimin e ngjeshjes Shtresë binderi me granit gur kave, 6cm, me makineri, ku duhet të realizohen të paktën 8 kalime mbi sipërfaqen e shtruar.
17	Rrul ngjeshës me vibrim deri 5 ton	1 copë	Për realizimin e ngjeshjes finale të tapetit/asfaltbetonit rreth, ku duhet të realizohen të paktën 4 kalime mbi sipërfaqen e shtruar.
20	Autobetoniere ATV	2 cope	Për ngjeshjen e trasës së kasonetes së rrugës. Ngjeshja do të bëhet me rula vibrues duke e lagur me ujë. Të paktën 4 kalime.
21	Autopompe betoni APV	1 copë	Për ngjeshjen fillestare të trasës së kasonetes së rrugës të paktën 4 kalime.
22	Sharre/prerese asfalti	1 copë	Për hapjen e njetrajtshme të shtresave të stabilizantit dhe cakullit, për zerin: Shtresë stabilizant, Shtresë çakelli përhapur dhe ngjeshur me makineri.
23	Skeleri minimumi 4800 m ²	1 copë	Për furnizimin me beton në kantier për realizimin e zerave betone.
24	Makineri/Fshese Asfalti	1 cope	Për hedhjen e betonit në veper.
25	Makineri frezimi traseje Rruge	1 copë	Për nevojat e prerjes së shtresave asfaltike në objekt.
27	Asfaltoshtruese	1 copë	Për realizimin e zerave të fasadave.
28	Autobitumatriçe	1 copë	Për sistemin pastrimit të sipërfaqeve të shtruara me asfalt.
29	Autobot uji	1 copë	Për ndërtimin e kasonetes dhe shtresave baze të aksit rrugor.
30	Pompa uji	3 copë	Për thyerje të materialeve pllaka gur në veper (mbi 700 m ² pllaka).
31	Autovinç me kapacitet ngritës të paktën 10 ton	1 copë	Për realizimin e shtresave asfaltike në veper sipas zerave të preventivit shtresave të asfaltit (binder+Asfaltbeton).

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Argumentimi
32	Kamion pajisur me kosh për punime ne lartesi	1 copë	Per sjelljen ne veper te emulsionit te bitumit mbi 15500 kg, hedhjes dhe shperhapjen e tij ne trajten e lengut te nxehte.
33	Bob Cat ose ekuivalent	2 copë	Per nevojat me uje gjate punimeve, gjate shtresave te cakullit dhe stabilizantit.
34	Pirun ngritës	1 copë	Per nevoja thithje te ujerave siperfaqesor, ne kanale etj.
35	Betoniere kantieri 500 litra	2 copë	Per nevoja te kantierit per elementet e parafabrikuar te betonit, tombino etj.
36	Depozita Uji 1000 litra	4 copë	Per realizimin e zerave Sinjalistike, Tabela te medha, pasqyra rrugore etj.
37	Armature dërrase	100 m2	Per punime te vogla rrugore ne kantier.
38	Paisje topografike/topogjeodezike GPS	1 copë	Per ngritje te materialeve ndertimore dhe transportin ne hapësira te vogla.
39	Semafore sinjalistike per punime rrugore	2 copë	Per prodhimin e betonit ne sasira te vogla.
40	Matrapik	1 copë	Te shperndara ne gjatesine e aksit per nevojat ndertimore.
41	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	40 copë	Per struktura, muret e betonit.
42	Fikse zjarri	20 copë	Per realizimin e rilevimit topografik te punimeve rrugore sipas projektit.
43	Jeleke Pune	130 copë	Per sistemimin dhe rregullimin e qarkullimit te mjeteve dhe qytetareve.
44	Prozhektore ndricimi	10 copë	Mjet ndihmes per realizimin e punimeve te prishjeve.
46	Makineri Vijezi rrugor boje bikomponente	1 copë	Per rregullat e sinjalizimit, te sigurimit teknik dhe drejtimin te levizjes dhe sigurise ne kantier.
47	Kompresor	2 copë	Per nevoja emergjente ne kushtet kur kemi perdorim te mjeteve makinerive, lendes djegese, emulsionit te bitumit, asfaltit etj.
48	Gjenerator minimumi 50KVA	2 copë	Veshje punonjesish ne kuader te rregullave te sigurimit teknik.
49	Zyre mobile (e levizeshme) kantieri	1 copë	Per nevojat e sigurise teknike ne erresire, kryerjes se punimeve emergjente apo perfundimit te proceseve te cilet nuk mund te nderpriten pavaresisht nivelin te ndricimit natyror.
50	Rimorkiator - Tërheqës	1 cope	Per montim ngule te tubove tabelave sinjalistike, etj.
51	Rimorkio kapacitet mbajtes mbi 30 ton për transportin e makinerive te rënda për në kantier (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)	1 cope	Per realizimin e zerit Vijezi shirita gjatesor dhe anesor gjeresi 12 cm, Bikomponente mbi 12600 ml.
52	Impiant/Fabrikë Asfalti pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B si dhe ISO 9001:2015, me kapacitet te paktën 100 ton/orë, me distance jo me te madhe se 50 km nga objekti i kontrates.	1 copë	Per nevojat e realizimit te punimeve te ndertimit, perdorimin e matrapikeve cekiceve pneumatike etj.
53	Fabrikë Betoni pajisur me leje mjedisi kodi III.1.B.	1 copë	Per nevojat me energji elektrike te pavarur nga rrjeti lokal.
54	Impiant/Nyje Inerte pajisur me leje mjedisi kodi III.1.B.	1 copë	Zyre kantieri ku do sherbeje per materialet e punes, sigurimit teknik, mbledhje, ushqim etj.
50	Rimorkiator - Tërheqës	1 cope	Koka terheqese e rimorkios - Mjet i nevojshem per transportin e makinerive te renda per ne kantierin e projektit dhe largimin prej tij (eskavatora, rrula, grejdera, buldozera etj.)
51	Rimorkio kapacitet mbajtes mbi 30 ton per transportin e makinerive te renda per ne kantier	1 cope	Mjet i nevojshem per transportin e makinerive te renda per ne kantierin e projektit dhe largimin prej tij (eskavatora, rrula, grejdera, etj.)
52	Impiant/Fabrikë Asfalti pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B	1 copë	Disponimin, ne format e pronesise, qirase, apo dhe marreveshjes se furnizimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit per përmbushjen me sukses te kontratës ne kohe dhe ne kushtet e volumeve te medha te materialeve Asfaltike, duke garantuar mos deshtimin e realizimit te projektit, kontrates.
53	Fabrikë Betoni pajisur me leje mjedisi kodi III.1.B.	1 copë	Disponimin, ne format e pronesise, qirase, apo dhe marreveshjes se furnizimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor per njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit per përmbushjen me sukses te kontratës ne kohe dhe ne kushtet e volumeve te medha te materialeve Betone, duke garantuar mos deshtimin e realizimit te projektit, kontrates.

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Argumentimi
54	Implant/Nyje Inerte pajisur me leje mjedisi kodit III.1.B.	1 copë	Disponimin, në format e pronësise, qirase, apo dhe marreveshjes së furnizimit, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës në kohë dhe në kushtet e volumeve të mëdha të materialeve Gure kave, Cakull, Stabilizant, rere etj., duke garantuar mos deshtimin e realizimit të projektit, kontratës.

Kategoritë e mësipërme janë kërkuar referuar zërave të preventivit dhe vlerës perkatese të cilat i pergjigjen klasifikimit të mesiperm.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme ose ekuivalent) Në rastet ofertimit si Bashkim të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë e vlefshme ose ekuivalent) Në rastet ofertimit si Bashkim të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor e vlefshme ose ekuivalent) Në rastet ofertimit si Bashkim të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas punimeve të marra persiper në marreveshjen e bashkepunimit (në rastin konkret zërat që lidhen me objektin e certifikates sipas preventivit).

ISO 50001:2018 (Sistemi i menaxhimit të energjisë e vlefshme ose ekuivalent) Në rastet ofertimit si Bashkim të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas punimeve të marra persiper në marreveshjen e bashkepunimit (në rastin konkret zërat që lidhen me objektin e certifikates sipas preventivit).

ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime e vlefshme ose ekuivalent). Në rastet ofertimit si Bashkim të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas punimeve të marra persiper në marreveshjen e bashkepunimit (në rastin konkret zërat që lidhen me objektin e certifikates sipas preventivit).

ISO 3834:2:2021 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim e vlefshme ose ekuivalent) Në rastet ofertimit si Bashkim të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas punimeve të marra persiper në marreveshjen e bashkepunimit (në rastin konkret zërat që lidhen me objektin e certifikates sipas preventivit).

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të perkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Keto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët e zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë, sigurisë në rrugë, trafiku, energjia dhe ulja e ndotjeve, janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t'u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Për ISO 9001-2015: Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqenëse Bashkia Selenicë si Autoritet Kontraktor kërkon punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

Për ISO 14001:2015: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001:2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësisë ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenicë si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

Për ISO 45001:2018: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mirë të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollat e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare.

ISO 39001:2012: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 39001:2012 i cili është një nga standardet më të rëndësishme sepse ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e infrastrukturës. Në këtë sektor, standardi fokusohet në dy aspekte kryesore: siguria e kantierit (gjatë ndërtimit) dhe siguria e përdoruesve (pas përfundimit të rrugës). Ndërtimi i një rruge shpesh bëhet duke mbajtur një pjesë të trafikut të hapur, gjë që krijon rrezik të lartë për eliminimin e të cilit duhen të ndiqen procedurat standarte ku të behet ndarja fizike e zonës ku punojnë makineritë e rënda (eskavatorët, rrulët) nga pjesa ku kalojnë makinat e qytetarëve. Duhet të ndiqen rregulla të rrepta për sigurimin dhe mbulimin e ngarkesave që të mos bien në rrugë, si dhe planifikimi i pikave ku kamionët e kantierit futen dhe dalin në rrugët publike pa krijuar rrezik për aksidente. Reduktimi i aksidenteve do të thotë që projekti nuk bllokohet dhe dorëzohet në kohë.

ISO 50001:2018: Për zbatimin e projekteve të ndërtimit, ISO 50001:2018 zbatohet në mënyrë specifike për të menaxhuar energjinë në dy nivele: në kantieret e punës (ku konsumi është dinamik dhe i përkohshëm) dhe në flotën e makinerive të rënda, Kantieri të reja shpesh nuk kanë lidhje direkte me rrjetin elektrik dhe përdorin gjeneratorë me naftë. Në ndërtimet publike duhet të zbatohen kujdesi mjedisor i cili realizohet me menaxhim energjike e cila con në uljen e emetimit CO2 në kantier.

ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime të vlefshme ose ekuivalente), kërkohej për garantimin e realizimit të standardeve të instalimeve në rrjetet e ujësjellësit dhe linjat e shërbimit KUB dhe KUZ etj.

ISO 3834:2:2021 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim të vlefshme ose ekuivalente) kërkohej për të përcaktuar dhe garantuar kërkesat gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike. Ky certifikim dëshmon se një operator ofertues, plotëson të gjitha kriteret teknike, profesionale dhe procedurale për të kryer punime saldimi të një sigurie dhe cilësie të lartë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zerave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Transport i mjetëve jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39 pika 6/a të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në nenin 4 pika e 1/b e ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, ku parashikohet se: "leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji". Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria "Menaxhimi i mjetëve". Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mjetëve", i ndryshuar, parashikohet se: "Qendra Kombëtare e Liçensimit lëshon licencën për transportin e mjetëve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", pas miratimit të saj nga ministri".

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të liçensimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta": "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mjetëve të llojeve të ndryshme".

2.3.11. Operatori Ekonomik duhet të disponojë, ose të ketë marrëveshje bashkepunimi/shërbimi dhe të paraqesë një kontratë/marrëveshje noteriale të lidhur me një laborator të akredituar nga Drejtoria e

Përgjithshme e Akreditimit, me afat vlefshmërie në përputhje me afatin e kryerjes së punimeve objekt kontrate, per analizat e betonit, binderit, asfaltobetonit dhe materialeve inerte.

2.3.12. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, të 6 muajve të fundit lidhur me materialet kryesore të preventivit të punimeve objekt prokurimi: Bitume, Binder, Asfaltobeton, Çakull, Stabilizant dhe Betone sipas klasave të preventivit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku citohet: "dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ne rastin konkret, kemi të bëjmë me një kërkesë minimale, për një dokument cilesie për materialet që autoriteti kontraktor, kërkon të blejë.

Persa me sipër kërkohej një dokument certifikuesi cilesie, pra në përputhje me nenin 77, ligji nr.162, datë 23.12.2021. dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara, që kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, sipas zerave të preventivit, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, pasi janë lehtësisht të siguroshme, me kosto të ulët, si dhe plotësueshme nga çdo operator që është në gjendje dhe do të realizojë një furnizim-vendosje si ai që kërkon objekti të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetese për keto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

- Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohtjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".